



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:259487  
Datë: 26.04.2024  
Numri i dokumentit: 05629968  
KE.nr.2776/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me gjyqtaren Verona Dibra, në çështjen juridike të paditësit Telekomi i Kosovës SH.A., me NUI: 811288001, me seli në Prishtinë, Lagjja “Dardania” p.n., të cilin e përfaqëson B.H. – Kryeshefe Ekzekutive, kundër të paditurit NPTSH “Reka Commerce”, me pronar E.R., me seli në Prishtinë, Lagjja “Arbëria”, me objekt kontesti përmbushje e kontratës, jashtë seancës më datë 26.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. KONSTATOHET se është tërhequr padia e paditësit Telekomi i Kosovës SH.A., me numër KE.nr.2776/22 (C.nr.1912/2005; 2022:259487) e datës 23.09.2005, me objekt kontesti përmbushje e kontratës, kundër të paditurit NPTSH “Reka Commerce”.
- II. Shpenzimet e procedurës i bartë secila palë veç e veç.

A r s y e t i m

Paditësi Telekomi i Kosovës SH.A., me parë “Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës” SH.A. – Vala 900, më datë 23.09.2005, ka paraqitur padi pranë Gjykatës Komonale në Prishtinë, kundër të paditurit NPTSH “Reka Commerce”, me të cilën ka kërkuar që të aprovet në tërësi si e bazuar kërkesëpadija e paditësit, si dhe të obligohet i padituri që t’i paguaj paditësit shumën prej 491.57 € në emër të përmbushjes së kontratës me kamatë në lartësi prej 3 %, duke filluar nga data e parashtrimit të padisë e deri në ditën e pagesës si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në afat prej 15 ditësh nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, lidhur me këtë çështje juridike kontestimore ka caktuar seancë përgatitore me datë 17.04.2024.

Pas pranimit të ftesës për seancë gjyqësore, paditësi Telekomi i Kosovës SH.A. me parashtrësën e dorëzuar në gjykatë më datë 29.03.2024, ka tërhequr padinë pasi që nga koha e paraqitjes së padisë e deri te caktimi i seancës përgatitore ka hyrë në fuqi Ligji për Faljen e Borxheve Publike Nr.05/L-043, me dispozitat e të cilit janë përcaktuar subjektet të cilat përfitojnë nga falja e borxheve që kanë obligime të pashlyera deri me datë 31.12.2008. Tutje ka deklaruar se, sipas këtij ligji, falje të borxheve përfitojnë edhe të gjithë personat të cilët kanë borxhe të pashlyera ndaj Institucioneve Shtetërore dhe Ndërmarrjeve Publike deri me datë 31.12.2008, përkatësisht që nuk kanë borxhe të tjera për periudhën 01.01.2009 deri 31.12.2014. Andaj në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore për tërheqjen e padisë pasi që pas verifikimit të kryer nga paditësi është konstatuar se i padituri borxhin e krijuar dhe të atakuar me padi e ka të periudhës 31.12.2008 dhe nuk ka borxh tjetër për periudhën kushtëzuese dhe është përfitues i faljes së borxhit sipas ligjit të lartcekur, dhe ky borxh është fshirë nga sistemi i paditësit dhe saldoja është 0.00.

Andaj Gjykata duke vepruar sipas parashtrësës së përfaqësuesit të paditësit, në kuptim të nenit 261 lidhur me nenin 387.1 pika c) dhe nenit 450 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr.2776/22, datë 26.04.2024

Gjyqtarja  
Verona Dibra

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi, nuk është e lejuar ankesa.